



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në përputhje me nenin 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës Nr.06/L-055, Ligjin për Gjykatat Nr.06/L-054, Rregulloren Nr. 04/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (01/2014) për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve dhe Vendimit KGJK Nr. 128/2023 të datës 06 prill 2023, shpall:

KONKURS TË BRENDSHËM PËR GJYQTARË

- GJYKATA E APELIT – 4 (katër) pozita për gjyqtar

KRITERET

- për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit, gjyqtari duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë si gjyqtar;
- Gjyqtari i cili aplikon për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit, përveç kushteve të veçanta për gjyqtarë të paraparë me nenin 32 të Ligjit Nr. 06/L - 054 për Gjykatat duhet të plotësoj edhe kriteret si në vijim:
- 2A.1.1. të ketë vlerësim të performancës në tre (3) vitet e fundit në shkallen “shkëlqyeshëm” ose “shumë mirë”;
- 2A.1.2. të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, përjashtimisht masën vërejtje jo publike me shkrim.

FORMULARI I APLIKIMIT

- formularin mund ta shkarkojnë në Ueb faqen e KGJK-së. (www.gjyqesori-rks.org)

[Shkarko Aplikacionin](#)

AFATI I DORËZIMIT TË APLIKACIONEVE

Formularët për aplikim dorëzohen, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga publikimi i konkursit, Sekretariatit e KGJK-së, Rruga “Luan Haradinaj” nr. 133, Prishtinë në Zyrën e Pranimit.

RREGULLAT DHE PROCEDURAT

Kandidatëve që aplikojnë për pozitat përkatëse do t`ju kërkohen dokumente të ndryshme për të mbështetur aplikacionin e tyre. Lidhur me këtë çështje, secili kandidat do të kontaktohet individualisht dhe përmes e-mail adresave për t`ju dërguar formularët dhe detajet për procedurat e mëtutjeshme.